



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 26.11.2018, ora 10.00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Seancë dëgjimore me shoqatat e biznesit për projektligjet financiare që shoqërojnë projektbuxhetin e vitit 2019.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Ilir Xhakolli, Arben Pëllumbi, Ervin Bushati, Roland Xhelilaj, Pjerin Ndreu.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Xhevit Bushaj, Reme Lala, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Luan Bregasi – përfaqësues nga *Business Albania*

Luigj Aleksi – përfaqësues nga *Business Albania*

Agim Rrapaj – përfaqësues nga *Business Albania*

Silvia Minotti – përfaqësues nga Dhoma Italiane e Tregtisë në Shqipëri

Alda Bakiri – përfaqësues nga Dhoma Italiane e Tregtisë në Shqipëri

Alketa Uruçi – përfaqësues nga Dhoma Amerikane e Tregtisë

Mark Crawford – përfaqësues nga Dhoma Amerikane e Tregtisë

Kujtim Hashorva – përfaqësues nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë

Bujar Bendo – përfaqësues nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë

Hazbi Parllaku – përfaqësues nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë

Nikolin Jaka – përfaqësues nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë

Bledar Mankollari – përfaqësues nga Dhoma Gjermane e Tregtisë dhe Industrisë në
Shqipëri

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Për shqyrtimin e projektligjeve financiare të paketës fiskale do të ishte shumë e vlefshme për ne të merrnin edhe opinionet e grupeve të interesit lidhur me ato ligje që janë paraqitur në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me qëllim që edhe diskutimi nën për nen, që do të zhvillohet në një seancë tjetër gjatë kësaj jave, të ketë edhe opinionin e grupeve të interesit për problematika të caktuara që lidhen ose përcaktohen drejtpërdrejt nga këto ligje. Pikërisht për këtë arsye jam i nderuar që sot në Komisionin e Ekonomisë ndodhen përfaqësuesit e grupeve të interesit, duke filluar me shoqatën “Business Albania”, e përfaqësuar nga zoti Luan Bregasi, Luigj Aleksi dhe Agim Rrapaj; me Dhomën e Tregtisë e Industrisë që ka konfirmuar prezencën, por, me sa duket, duhet të kenë ndonjë problem, zoti Nikolin Jaka; me Dhomën Amerikane të Tregtisë, e përfaqësuar nga zonja Alketa Uruçi dhe zoti Mark Crawford; me Dhomën Gjermane të Tregtisë dhe Industrisë në Shqipëri, e përfaqësuar nga Bledar Mankollari; me Dhomën e Italisë në Shqipëri, e përfaqësuar nga zonja Silvia Minotti.

Do të procedojmë me opinionet tuaja. Në rast se anëtarët e komisionit kanë interes për të marrë sqarime të mëtejshme lidhur me propozimet tuaja, pa asnjë lloj diskutimi që do të adresohen pyetje dhe jeni të lutur të na jepni disa përgjigje.

Fillojmë me zotin Bregasi.

Luan Bregasi – Shumë faleminderit, të nderuar deputetë të Komisionit të Ekonomisë!

Ju falënderoj shumë për organizimin e kësaj dëgjese me shoqatat e biznesit! *Business Albania* dhe shoqatat që e përbejnë atë, dhe unë personalisht si sipërmarrës mendoj se këtë vit kemi një buxhet më të mirë. Nuk e them këtë për t’u bërë qejfin vetes dhe juve, por realisht kemi një buxhet që mbështetet në një rritje ekonomike 4,3% dhe ky është një lajm shumë optimist dhe një sinjal pozitiv për ekonominë shqiptare.

E dyta, ka investime të konsiderueshme, të cilat janë të rëndësishme për një sipërmarrje private.

E treta, është një buxhet që tenton të ulë borxhin, madje jo vetëm tenton, por aty ka edhe një shifër që është një objektiv shumë i rëndësishëm dhe shumë optimist për të ardhmen e ekonomisë së vendit.

Ajo që na bën përshtypje është fakti se ky është një buxhet i konsoliduar fiskalisht. Jemi të gjithë të ndërgjegjshëm që në Shqipëri buxheti nuk shkonte më shumë se 20%-25% të gjithë

prodhimit të përgjithshëm bruto. Tashmë ky buxhet tenton të shkojë drejt 27,5%. Ky është një sinjal i mirë që tregon se vendi, ekonomia shqiptare ka filluar të formalizohet dhe bizneset po shkojnë drejt rregullit dhe zbatimit të ligjit.

Sigurisht, e kemi përshëndetur dhe e kemi mbështetur uljen e dividendit nga 15% në 8%. Duhet thënë se ka qenë 10% dhe u bë 15%, më pas u bë 8%. Besoj se këtë duhet ta dimë edhe ne si sipërmarrës. Shqipëria ecën më mirë me një nivel taksash më të ulëta dhe me një bazë tatimore më të madhe. Për shkak të kësaj filozofie ne e kemi mbështetur dhe e kemi përkrahur këtë lëvizje. Edhe rritjen e fashës së taksimit të pagave nga 130 mijë në 150 mijë është një lajm pozitiv, megjithëse për ne duhej të ishte guxuar pak më shumë nga ana e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Madje, meqë jemi këtu, do të kërkonin, se e kam dëgjuar në komision nga zoti Erion apo më duket e dëgjova diku në lajme, se ka bërë një propozim për të rritur fashën e tatueshme të pagave nga 30 mijë në 40 mijë. Për ne biznesmenët do të ishte shumë e mirë një gjë e tillë, sepse realisht ne paga nën 30 mijë lekë, me përjashtim të fasonëve nuk kemi. Kjo do të thotë se edhe një pastruese në një hotel nuk merr më pak se 40 mijë lekë në muaj. Në rast se e rritim këtë fashë, do të shmangnim një evazion shumë të madh që bëjnë kompanitë që i kanë pagat nga 30 mijë deri në 40 mijë lekë të rinj.

Shoqatat e biznesit bënë shumë propozime për buxhetin, por duhet të themi se shumë pak prej tyre janë marrë parasysh. Ajo që mendoj unë dhe biznesmenët është se ne nuk e kemi luksin që të bëjmë lëvizje shumë të mëdha, pra ndryshime të forta, por kemi luksin që çdo vit të bëjmë nga një lëvizje, ndonjë përmirësim të legjislacionit që çon në rritjen e konkurrueshmërisë në treg. Po t'i shikoni propozimet që kemi bërë këtë vit, zoti Erion dhe të nderuar deputetë të tjerë, ato synojnë rritjen e konkurrueshmërisë së industrisë vendase prodhuese, përpunuese; e dyta, formalizimin e ndërmarrjeve dhe të krijuarit të një klime të qëndrueshme biznesi në Shqipëri.

Ju kemi bërë një letër ju dhe ia kemi dërguar edhe Kryeministrit Rama. Unë do të flas për industrinë prodhuese, pasi për sektorin e ndërtimit do të flasë zoti Luigj, që është zëvendës-president i biznesit dhe kryetar i shoqatës, për bujqësinë do të flasë zoti Rrapaj.

Çfarë kemi kërkuar?! Energjia dhe uji kanë kosto shumë të larta në industrinë prodhuese dhe përpunuese vendase. Ne ju kemi mirëkuptuar para disa vjetësh, kur rritëm çmimin e energjisë, sepse humbjet në rrjet ishin gati 45%-50%. Tashmë, për shkak të një organizimi më të mirë të sektorit të energjisë elektrike, për shkak të administrimit më të mirë të OSHEE-së, për

shkak të rritjes së ndërgjegjes së njerëzve për të paguar taksën e energjisë elektrike, ne mendojmë se ka ardhur koha që për biznesin të ketë një diferencë të çmimit të energjisë elektrike. Jemi vendi i vetëm jo vetëm në rajon, por edhe duke u krahasuar me vendet e BE-së që biznesi e ka çmimin e energjisë sa dyfishë i energjisë së popullatës, duhej të ishte e kundërta, por ne i mirëkuptojmë për një gjë. Ne ju mirëkuptojmë për këtë gjë. Në rast se humbjet në rrjet janë ulur 25%, na e ulni edhe në çmimin e energjisë në masën 20%-25%. E njëjta gjë ndodh edhe me ujin, me akcizën e solarit, me parapagimin e akcizës. Kur të gjitha kompanitë kanë garanci bankare, pse duhet ta parapaguajmë akcizën? Kompanitë prodhuese kanë shumë vështirësi për të bërë parapagime. Ne parapaguajmë akcizën, taksën e pullës fiskale e shumë taksa të tjera dhe nuk kemi mundësi të blejmë lëndët e para. Sigurisht që ne i kemi bërë të gjitha këto propozime. Kemi gjetur konsensus me zotin Ahmetaj për të bërë diçka. Nuk e di se çfarë do të bëhet nga këto.

E kemi shkruar edhe në letra që nuk ka asnjë vend në botë të ketë akcizë qelqi, kur qelqi është i riciklueshëm, lëre pastaj kur është ambalazh i kthyeshëm. Ne e kemi parapagim akcizën e qelqit, akcizë për solarin, për pullën për këtë, për atë. Domethënë, jemi shumë të ngarkuar nga pikëpamja fiskale. Realisht, me atë analizë që kemi bërë, nuk është një letër për t'u ankuar, por është një letër që të bëjmë ç'është e mundur që të gjithë deputetët, sidomos të Komisionit të Ekonomisë, ta shikojnë seriozisht mungesën e konkurrueshmërisë në treg të kompanive tregtare në Shqipëri. Nuk kemi konkurrencë me vendet e rajonit. Kosova e ka energjinë gjysmë për gjysmë me Shqipërinë dhe ujin e ka katër herë më të lirë se ne. Si do t'i konkurrojmë ne produktet që vijnë nga Kosova, kur kostot e energjisë, ujit dhe akcizat e tjera i keni shumë të larta? Sigurisht, nuk do të zgjatëm shumë në këtë gjë. Unë jam i ndërgjegjshëm edhe si sipërmarrës që ekonomia jonë nuk ka shumë këllqe të bëjë lëvizje të forta, por disa lëvizje të vogla duhet t'i bëjmë çdo vit, me qëllim që gradualisht ne dhe ju së bashku të jemi më optimistë për të ardhmen e këtij vendi, duke rregulluar çdo vit ndonjë gjë. Siç ka thënë edhe e madhja Nënë Terezë: "Nuk jemi vend i madh të bëjmë gjëra të mëdha". Ne jemi vend i vogël dhe do t'i bëjmë gjërat e vogla me dashuri më të madhe dhe me respekt më të madh ndaj industrive, ndaj prodhuesve dhe ndaj biznesit.

Faleminderit!

Erion Braçe – Zoti Bregasi, a do të flasë dikush tjetër nga ju?

Luan Bregasi – Po, për ndërtimin do të flasë Luigji, për bujqësinë Gimi.

Erion Braçe – Në rregull.

Urdhëroni!

Luigj Aleksi – Siç e tha edhe zoti Luan, ne i kemi përshëndetur veprimet që ndërmori Ministria e Ekonomisë dhe Financave për heqjen e kuotës së fitimit për pronarin e truallit, që ngarkohej ndërtimi, dhe për uljen e dividendit. Megjithatë, sektori i ndërtimit ka disa shqetësime, të cilat ne i kemi ngritur vazhdimisht. Ato, për mendimin tonë, nuk janë përmirësime që ndikojnë në rritjen e fitimit të shoqërive të ndërtimit, por ndikojnë në përmirësimin e ekonomisë dhe, në fund të fundit, ngarkohen blerësi.

E para është taksa e infrastrukturës që i paguhet bashkisë, e cila është 8% mbi çmimin e shitjes. Ka qenë 5% mbi koston. Ky ndikim është i barabartë me një rritje 20% mbi çmimin e koston. Pra, nëse sot ndërtohet në Tiranë me 400 euro për metër katrorë, shtohet një 100 euro, të cilat në fund do t'i paguajë direkt ai konsumatori që do t'i blejë, sepse ndërtuesi nuk ka ku t'i shkarkojë. Kjo taksë e ndikimit në infrastrukturë jo vetëm paguhet në këtë vlerë, por më e keqja është se nuk zbriten punimet që bëhen për infrastrukturën. Ndërtuesi e bën infrastrukturën me fondet e tij, të cilat duhet të jenë punime të zbritshme nga vlera e kësaj takse, se ky është qëllimi i saj.

Për ndikimin që ka në ekonomi, dua të flas disa sekonda. Fuqia punëtore për ndërtimin e një pallati me 10 mijë katrorë, mbi të cilën do të paguhet në bashki rreth 400 mijë euro, është e barabartë me atë që për një vit të mos punojnë 200 punonjës. Tani, të gjykojmë të gjithë ekonomikisht është më mirë të lëmë 200 punëtorë pa punë, të mos i punësojmë apo të ulim taksën e ndikimit në infrastrukturë në nivelet e mëparshme?! Ky është njëri problem.

Problemi i dytë është 3% i strehimit social, i cili është i barabartë, me llogaritë e bëra, me minimumi 20% të fitimit neto që ka një shoqëri ndërtimi nga ndërtimi i një godine për shitje. Ndërtuesit i bëhet diskriminim, sepse është i vetmi sektor që ngarkohet me këtë taksë, në një kohë kur ne jemi shprehur se nuk jemi kundër taksës së solidaritetit dhe kemi pranuar më mirë të rritet si taksë për të gjithë biznesin. Më mirë të rritet fitimi, nga 15% të bëhet 16%, si taksën solidariteti dhe t'i shkojë në vlerë, se edhe ky ligj është një amalgamë dhe bashkia kurrsesi nuk është në gjendje ta marrë. Nuk e administroj dot. Kështu që kemi thënë se është më mirë të jepet... Plus kësaj ndërtuesit kanë vite që e kanë shprehur dhe kanë bërë projekte të tilla që të jenë për shtresat në nevojë me kosto mjaft të ulët dhe me idenë që, siç punon ndërtuesi me

pronarë privatë, të punojë ndërtuesi me pronarë truall shtet. Kështu që ajo kostoja e truallit shtet, që jep 30%-35%, është kosto që mund të shkojë fare mirë për shtresat në nevojë.

Problemi i tretë është taksa e dherave. Është një keqinterpretim i qëllimshëm i katalogut europian dhe katalogut shqiptarë që janë të unifikuara në vendimin e qeverisë për klasifikimin e mbetjeve. Dheu në Shqipëri konsiderohet mbetje inerte e rrezikshme, kur ligji dhe normativa europiane, të cilit i referohet ky vendim, e shkruan të zezë mbi të bardhë që dheu është mall dhe shitet e blihet e jo mbetje e rrezikshme. Paguajmë 700 lekë për një metër kub dhe që hiqet nga toka, kur ai dhe fare mirë merret e bëhet lulishte. A i imagjinoni që dheu, i cili do të gjërmohet në qendër të Tiranës, kur të bëhet teatri, ne do ta quajmë dhe të kontaminuar, atëherë ne kemi një Tiranë të kontaminuar. Ligji e shpreh të zezën mbi të bardhë. Megjithatë, kjo është bërë në mënyrë të qëllimshme dhe ndikon në një godinë të madhe, mbi 150 mijë euro.

Erion Braçe – Më fal, zoti Aleksi, në cilin ligj është vendosur kjo?

Aleksi- Është vendimi i qeverisë nr. 575, i cili është i mbështetur në katalogun shqiptar të mbetjeve, i unifikuar me katalogun europian të mbetjeve. Në vendim të katalogu europian dhe të direktivës europiane shkruhet që dherat vetëm nga zonat e kontaminuara quhen mbetje inerte të rrezikshme, ndërsa këtu te ne nuk përjashtohen. Çdo dhe që merret duhet paguar.

Taksa e pronës. Apartamentet e pashitura, që nuk janë në qarkullim, por janë mall stok, do të taksohen me taksën e pronës së ndërtuesit, ata janë mall, siç dikush ka lavatriçe në magazinë ai ka apartamente për shitje, të cilat nuk taksohen, por do të taksohen. Ne e kemi ngritur këtë problem në Ministrinë Financave dhe mendojmë se duhet riparë me kujdes.

Së fundi, për ne ndërtuesit dhe për të gjithë ekonominë e vendit, problemi kryesor në buxhet është prokurimi publik. Ligji i prokurimit publik duhet rregulluar sa më parë në dy aspekte: në kapitullin e reprizitave dhe në kapitullin e shpalljes së subjektit fitues. Po të shikoni në kompjuter vetëm për rikonstrukcionin e shkollës “Dritëro Agolli” në Devoll, me 71 milionë, që tenderohet në dhjetor, kërkohen 11 inxhinierë, pra për të bërë një rikonstrukcion shkolle, dhe midis tyre edhe një inxhinier pyjesh dhe 150 punëtorë. Vetëm me një llogari të thjeshtë na del që paga e këtyre personave për 9 muaj është më e madhe sesa vlera e të gjithë objektit.

Faleminderit!

Erion Braçe – Zoti Aleksi, a mund të di, për kuriozitet, se cili ishte enti prokurores për këtë rast?

Aleksi – Bashkia Devollit.

Luan Bregasi – Faleminderit!

Programi për bujqësinë dhe buxheti për vitin 2019 është pothuajse në të njëjtat nivele si ai i vitit 2018, por shqetësimi ynë lidhet me ndarjen e këtij buxheti sipas strukturës së tij, ku është ulur ndjeshëm buxheti për sigurinë ushqimore, me rreth 28%.

Kam edhe dy probleme të mëdha që duhen adresuar.

I pari lidhet me TVSH-në për shërbimin veterinar, i cili tatohet me 20%, që për mendimin tonë është i padrejtë, pasi shërbimi human nuk taksohet me TVSH, importi i medikamenteve veterinare nuk taksohet me TVSH, vetëm shërbimi që bëhet për vaksinimin taksohet me TVSH. Në sektorin privat ky taksim ka sjellë probleme dhe mungesa e financimeve nga buxheti për këtë zë ka sjellë pasoja, të cilat, nëse nuk rregullohen, mund të thellohen më shumë në vitin 2019. Ne kemi folur me Ministrinë e Bujqësisë dhe Ministrinë e Financave, të cilët e dinë si problem, por me sa shohim nuk e kanë nxjerrë në buxhet.

Erion Braçe – Domethënë, kanë rënë dakord që shërbimi veterinar të përjashtohet nga TVSH-ja?

Luan Bregasi - Po, Ministria e Bujqësisë.

Erion Braçe –Po Ministria e Financave a ka qenë dakord?

Luan Bregasi– Po, në takimet që kemi bërë Ministria e Financave ka qenë dakord, por ende nuk kemi një përgjigje.

Momenti i dytë ka të bëjë me mbetjet e kafshëve dhe mbetjet organike. Ky është një problem shumë i madh dhe për këtë nuk janë planifikuar fonde për këtë vit. Ky problem duhet adresuar, sepse janë 1 milion ton mbetje organike në Shqipëri që degradohen çdo vit. Shqipëria përpunon vetëm 4 mijë ton në vit dhe e gjithë pjesa tjetër dekompozohet në natyrë, duke sjellë një sërë pasojash për shëndetin e njerëzve, kafshëve, turizmin, agroturizmin e të tjerë. Këto probleme duhen adresuar dhe ky është momenti i duhur.

Çështja e fundit ka të bëjë me...

Erion Braçe –Çfarë propozimi kishit për mbetjet?

Luan Bregasi – Të shtohet një zë në buxhet për përpunimin e mbetjeve organike.

Erion Braçe – Kush t’i përpunojë?

Luan Bregasi – Ato i përpunon privati, por ministria, në bazë të vendimit të qeverisë nr. 127, i cili hyn në fuqi në muajin janar të vitit 2019, ka një zë të veçantë në buxhet, ku nuk do të lejojë më që mbetjet organike nga kafshët të hidhen siç janë hedhur deri sot.

Momenti tjetër ka të bëjë me formën e organizimit dhe me formalizimin. Këtë vit janë hequr fondet për regjistrin e fermës. Ne, si sektor privat, me ndihmën e qeverisë së Japonisë kemi nisur një program të vogël për të nxitur sektorin privat, por pa regjistrin e fermës ne nuk do të disbursojmë dot fondet dhe ky është problemi më i madh që ne do të kemi. Unë nuk fola për sasinë e fondeve, sepse sivjet do të ketë fonde edhe nga IPARD-i , edhe nga Bashkimi European, por shqetësimi ynë ka të bëjë me disbursimin e fondeve. Në qoftë se ne nuk do të krijojmë terrenin për të disbursuar këto fonde, do të ndodhemi përpara vështirësive, ashtu siç ishim këtë vit.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit!

Atëherë, vazhdojmë seancën dëgjimore me përfaqësuesen e Dhomës së Tregtisë Italiane në Shqipëri, zonjën Silvia Minotti.

Silvia Minotti – Unë përfaqësoj Dhomën e Tregtisë Italiane në Shqipëri. Sugjerimet dhe komentet tona për sa i përket rimbursimit të TVSH-së dhe të akcizës ne ia kemi kaluar Ministrisë së Financave, që janë në linjë me kolegët tanë. Dua të sjellë në vëmendjen tuaj një problematikë, e cila na shqetëson dhe është shumë e rëndësishme për ne. Ne e vlerësojmë nxitjen dhe riskun e qeverisë për të ulur nivelin e taksimit për sipërmarrjen, por në të njëjtën kohë ne shohim se ka një sërë ligjesh dhe nismash ligjore që, edhe pse nuk shprehen në formën e një takse formale, përfaqësojnë një taksë të fshehur për ndërmarrjet. Domethënë, bëhet fjalë për ligje dhe VKM, të cilat miratohen nga Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave pa konsultim publik. Për shembull, taksa për sigurisë publike, është një ligj i miratuar në vitin 2016, ku aktet nënligjore janë miratuar pak kohë më parë. Ne e konsiderojmë taksë, sepse përfshin të gjitha bizneset që kanë xhiro mbi 10 milionë lekë, të cilët kanë detyrimin të vendosin kamera dhe njëkohësisht të kenë polici private. Kjo ndodh edhe për sipërmarrësit, të cilët nuk janë të ndërgjegjshëm se sa kamera duhen aty, pasi në atë territor nuk kanë pasur probleme. Me ironi duhet të them që është një ligj i bërë për shoqëritë, të cilat shesin telekamera ose për policitë private, por e di që nuk është kështu.

Ne kemi bërë një sondazh në vendet e rajonit dhe në ato afër Shqipërisë, por asnjë shtet nuk na rezulton të ketë një ligj të tillë. Sipërmarrësi është vetë përgjegjës për hapësirën dhe vendin e punës, por nuk mund të shkarkohet mbi ndërmarrjen kostoja e sigurisë publike dhe policia e zonës të vendosë numrin e telekamerave që duhet të vendosen dhe si duhet të vendosen

në një biznes. Kështu që ne ftojmë qeverinë që ta rishohë edhe një herë këtë taksë, sepse, në të kundërt, ne jemi të detyruar ta vendosim këtë taksë në guidën për investimet në Shqipëri, e cila është kosto që biznesi duhet ta përballojë në momentin që vendos të investojë në Shqipëri.

Kam edhe një rast shumë të shkurtër legjislativ. Në këtë moment po diskutohet ligji për mbrojtjen civile. Ne nuk jemi të përfshirë në asnjë komision, që po merret me draftimin e këtij ligji, për të dhënë mendimet tona, por thjesht u vumë në dijeni nëpërmjet shtypit. Kështu që, në këtë rast vetë biznesi duhet të ketë një kosto shtesë, i cili duhet të njoftojë ose të informojë komunitetin se çfarë duhet të bëjmë në rastet e një fatkeqësie natyrore. Për shembull, këtu parashikohet që policia në çdo moment mund të përdorë mjetet tona, që gjenden në vendin e punës, për nevoja të emergjencës. Në këtë rast ndërmarrja mund të marrë pjesë në mënyrë vullnetare në emergjencën publike, por jo detyruese. Mbi të gjitha, çdo vend që ka mbrojtjen civile ka mjetet e veta që mund t'i përdori për këto raste dhe mjetet që disponon biznesi nuk janë të përshtatshme për të bërë një ndërhyrje të tillë. Kështu që, edhe një herë ne shfaqim gatishmërinë tonë për të pasur një dialog konstruktiv me biznesin, por njëkohësisht informojmë aktorët kryesorë në vend për këtë mekanizëm, që është pak i vështirë, sepse me këtë mënyrë legjislative duket sikur qeveria bën një hap para, por në fakt bën dy hapa mbrapa.

Bashkimi Europian ka njoftuar dhomat e tregtisë për zhvillimin ekonomik, për hapat që bën përpara qeveria, dhe ne vëmë në dukje përmirësimin për sa u përket licencave, procedurave dhe shumë hapave të tjerë që ka bërë qeveria përpara, por këto dy ligje, të cilat i nënvizua pak më parë, kanë një kosto që ndikon në zhvillimin e biznesit. Në vende të tjera të botës, në çdo moment që qeveria vendos të shkruaj një draftligj, ekziston një komision, i cili vlerëson kostot dhe impaktin që do të ketë ky draftligj mbi biznesin.

Nga njëra anë, qeveria harxhon para për të lehtësuar dhe, nga ana tjetër, miratohen ligje, të cilat ndikojnë në zhvillimin e biznesit tonë në Shqipëri.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zonjë! Keni shumë të drejtë për këtë aspekt.

Kalojmë te Dhoma Amerikane e Tregtisë!

Fjalën e ka zoti Mark Crawford.

Mark Crawford – Faleminderit për ftesën!

Ne duam të falënderojmë Ministrinë e Financës, ku kemi dërguar disa komente në lidhje me paketën fiskale në tetor.

Dua të filloj me urimin, sepse ka pasur një rënie të borxhit dhe për këtë qeveria duhet të shfrytëzojë hapësirat që ka.

Kam disa pika, që dua t'i përmend, për këtë paketë komentesh dhe më pas do t'ia lë fjalën zonjës Uruçi, për disa detaje më shumë.

Së pari, hapat pozitive që kemi vënë janë çështjet në gjykatë.

Së dyti, taksa dividende është duke u ulur. Kjo gjë për ne është pozitive, por përsëri kemi këndvështrimin tonë kundrejt rajonit dhe nëse ne jemi në 8%, kurse Kosova me zero. Nga pikëpamja jonë taksa e dividendit është një taksë dyfish, sepse të gjitha kompanitë paguajnë taksë fitimi. Kështu që, ne duhet të urojmë që kjo mbledhje të heqë sa më shumë pengesat, sidomos për shqiptarët që do të investojnë në Shqipëri. Taksa e dividendit është një pengesë, që të jemi konkurrentë me rajonin dhe të investojnë në Shqipëri.

Së treti, që është edhe më specifike, taksa akciza për zhavorrin bituminoz. Në sipërfaqe duket si një taksë e vogël, por kur bëhet kalkulimi, i takon 70% të vlerës së zhavorrit bituminoz kur është i përpunuar. Kështu që duhet rishikuar taksa e akcizës për këtë gjë.

Së katërti, ne duhet të kemi një përputhje midis taksës personale me biznesin e vogël, pra sidomos ato biznese që kanë vetëm një pronar, të mos kenë incentivë për individët që punojnë në biznesin e tyre, pra t'i ndajnë bizneset në kompani të ndryshme për të shmangur, disnivel midis taksës personale dhe taksë mbi biznesin e vogël.

Së fundi, ne të Dhomës Amerikane duam një sqarim për taksën mbi fitimin kapital, sidomos kur një transaksion jashtë shtetit kur është transaksioni në nivelin e nënës, të gjyshërit. Ne në Amerikë kemi shumë qejf t'i taksojmë amerikanët që jetojnë jashtë shtetit. Ne në Amerikë jemi bashkuar me Afrikën dhe me Korenë e Veriut dhe përpiqemi të taksojmë transaksionet që janë jashtë shtetit. Në fund të fundit, me gjithë fuqitë e amerikanëve kemi dalë në konkluzionin se kjo iniciativë ka dalë me më shumë shpenzime se sa fitime për ne. Kështu që, në qoftë se Shqipëria do të fillojë të ndjekë transaksionet që janë jashtë Shqipërisë dhe shumica e pasurive të huaja vijnë nga kompani të tjera, pra të kuptojnë si do të jetë taksa për ata. Unë uroj që Shqipëria të mos ndjekë shembullin e Amerikës, as të Koresë e Veriut në këtë aspekt dhe të fokusoheni në përmirësimin e vendit për të tërhequr më shumë investime se sa të taksojnë transaksionet që janë jashtë Shqipërisë.

Po ia kaloj fjalën zonjës Uruçi për më shumë detaje.

Alketa Uruçi – Përsëritje!

Ashtu siç tha edhe Marku, ne si Dhomë Amerikane kemi përmbledhur komentet e anëtarëve të Dhomës dhe i kemi dërguar për paketën fiskale, pranë Ministrisë së Financave, në muajin tetor, kur u bënë të ditura projektligjet e qeverisë për paketën fiskale, ashtu edhe pranë Komisionit të Ekonomisë. Kështu që do të përmendim vetëm disa çështje që janë më të rëndësishme, por në komentet tona kemi dhënë një analizë të detajuar të komenteve që kanë anëtarët e dhomës për paketën fiskale.

Sigurisht, në këto komente përmenden gjëra që anëtarët e Dhomës mendojnë se duhen përmirësuar, ndërkohë kjo paketë fiskale ka edhe gjëra pozitive, siç është ulja e tatimit mbi dividendin. Gjithsesi, ka një masë të dytë, një parashikim në dispozita transitore, me të cilin anëtarët e Dhomës Amerikane nuk janë dakord. Pra, bëhet fjalë që tatimi mbi dividendin do të bëhet në masën 8%, nga 15% që është aktualisht, por qeveria parashikon që në dispozita transitore të vendos një ligj, i cili thotë: “Dividendi, i cili u takon periudhave deri në vitin 2017 plus vitin 2018, duhet të shpërndahet dhe tatimi duhet të paguhet brenda datës 20 gusht dhe 30 shtator të vitit 2019”, përndryshe, sipas qeverisë, ky dividend nuk do të tatohet më me 8%, sa është masa e tatimit tani, por duhet të tatohet me 15%.

Së pari, kjo ndarje ndërmjet dividendit të viteve 2017 dhe më parë dhe disidentëve të rinj nuk është e bazuar në ligj, sepse sipas ligjit “Për shoqërinë tregtare”, dividendi, quhet dividend në momentin që asambleja vendos ta shpërndajë. Përpara kësaj date dividendi, ose ajo që ne quajmë dividend është një fitim i pashpërndarë, që është në bilancin e kompanisë. Kur asambleja vendos të shpërndajë dividend, ligji tatimor duhet të parashikojë që të zbatohet ajo masë tatimi që është në fuqi në atë datë.

Dua t’ju kujtoj se kur tatimi mbi dividendin u rrit nga 10% në 15%, dividendi i shpërndarë gjatë periudhave 2014 deri më sot nuk është tatuar ndryshe për periudhat para vitit 2014, domethënë me 10%, dhe ndryshe për vitet 2014-2017. Përkundrazi është zbatuar masa e tatimit mbi dividendin 15%, që është në fuqi në kohën kur shpërndahet dividendi. Rrjedhimisht, duam t’i sugjerojmë komisionit që të lihet dispozita që tatimi mbi dividendin është 8%, dhe të mos miratohet dispozita transitore për dividendin, pra për atë që qeveria e quan inventivë ose amnisti, por që për anëtarët e dhomës nuk është e tillë, përkundrazi është një detyrim i bizneseve që ta shpërndajnë dividendin e viteve të mëparshme brenda gushtit të vitit 2019.

Së dyti, do të përmendim dispozitat e reja për fitimet kapitale për tatimin në rastin e shitjes së kuotave ose aksioneve të shoqërive, për të cilat që vlera mbi 50% përbëhet nga të

drejta koncensionare apo pasuri të paluajtshme që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në lidhje me këtë pikë anëtarët e dhomës sugjerojnë që të vihet një dispozitë specifike, siç është në gjitha vendet evropiane, që ristrukturimet dhe shitjet brenda grupit të mos jenë subjekt i taksës mbi fitimet kapitale, meqenëse ortaku kryesor i grupit nuk ndryshon. Besoj se kjo të shmangë koston tatimore në rastet e ristrukturimit të grupeve, pra në rastet kur kemi bashkime shoqërisht, kur kemi transferim të kuotave nga njëra shoqëri tek tjetra, por jemi gjithmonë brenda të njëjtit grup.

Së treti, ka një iniciativë nga ana e qeveris për vendosjen e penaliteteve për rastet kur kryhet aktivitet nga ata që quhen subjekte pasive. Subjektet pasive janë subjekte që nuk kryejnë aktivitet, janë të regjistruar në një regjistër pranë administratës tatimore, dhe në këtë moment nuk i deklarojnë formularët e tatimeve e të tjera me radhë. Ka një propozim në projektligj, që nëse subjektet pasive rezultojnë se kanë lëshuar fatura, kanë kryer furnizime mallrash e të tjera me radhë, ato duhet të penalizohen. Ne nuk kemi asnjë koment në lidhje me këtë gjë. Ajo që na shqetëson është fakti se penalizohen edhe subjektet aktive nëse u kanë lëshuar fatura subjekteve pasive.

Këtu dua t'ju kujtoj se subjektet pavarësisht se mund të jenë në status pasive, kanë një llogari bankare. Këto subjekte kanë një seli, që e kanë me qira dhe sido që të jetë, pavarësisht se nuk kanë aktivitet do të mbledhin kreditë që kanë kundrejt personave të tretë. Rrjedhimisht do të ndodhemi në situatën, ku banka do t'ju bëjë një faturë ose do t'ju lëshojë një komision për llogari bankare subjekteve pasive. Shoqëritë e telekomunikacionit që faturojnë në fund të muajit, pavarësisht statusit të subjektit nëse është subjekt pasiv apo jo, duhet të faturojë shërbimin që ata kanë ofruar gjatë muajit dhe mund të ndodhemi në disa situata absurde. Për shembull, kur tatimpaguesit shoqëri në fushën e telekomunikacioneve, banka e të tjera me radhë do të gjenden në situata ku duhet të penalizohen për çdo faturë që u lëshojnë subjekteve pasive.

Së dyti, zgjidhja praktike ose implementimi praktik është fakti se statusi i subjekteve pasive publikohet nga ana e drejtorisë së përgjithshme në një dokument Pdf që nuk tregon as datën kur ky subjekt ka kaluar në status pasiv. Rrjedhimisht çdo subjekt që kryen aktivitet e ka shumë të vështirë që të shkojë dhe të kërkojë në këtë dokument në Pdf blerësin potencial të mundshëm dhe para se t'i shesë një furnizim, të kryejë një furnizim malli ose shërbimi, të verifikojë nëse është në statusin pasiv blerësi, apo jo. Sigurisht, duhen penalizuar subjektet që

kryejnë aktivitet, pavarësisht se kanë deklaruar se janë në status pasiv, por penalizmi të mos vendoset edhe për subjektet shitëse, domethënë kur ju shesin këtyre subjekteve.

Çështja tjetër që duam ta ngremë këtu, ka lidhje me ndryshimin e ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, ku parashikohet të mbahet tatim në burim për të gjitha shërbimet kryera nga një person jorezident. Deri tani ligji parashikonte se nëse furnizimet janë kryer nga një person jorezident, por janë kryer në një territor jashtë Republikës së Shqipërisë, atëherë nuk mbahet tatim në burim mbi këto pagesa. Ndërkohë, nëse personi jorezident, shoqëria e huaj, vinte dhe e kryente në territorin shqiptar, duhej të mbahej tatimi në burim në masën 15%, përveçse kur aplikohet një marrëveshje tatimore, e cila e ulte këtë ose e shmangte pagesën e tatimit. Praktikisht, sipas anëtarëve të dhomës, kjo do të krijojë një kosto për subjektet, për konsumatorin dhe për bizneset. Pse? Për shembull, kemi komisionet e suiftit ose komisionet e bankave korrespondente, nëse do të mbahet 15% tatim burim mbi këto lloj komisionesh, atëherë e gjithë kjo do të kalojë në një kosto për komisionet bankare në territorin shqiptar. Me kaq shumë marrëdhënie sa kanë bankat me bankat korrespondente, është e pamundur që një bankë e huaj të pranojë të aplikojë ose të bëjë formularët e shmangies së tatimit nëburim mbi bazën e një marrëveshje tatimore për shmangien e tatimit në burim, pikërisht mbi komisionet që ajo i çarxhon një banke shqiptare.

Rasti tjetër, që është edhe më i dukshëm, për shembull, është mbajtja e tatimit në burim për një pagesë të një hoteli jashtë. Nëse një hotel të bën një faturë për faktin që t’i ke qëndruar në atë hotel të huaj, tashmë, sipas kësaj dispozite të re, duhet të mbahet tatim në burim për hotelin.

Së pari, kjo mund të ndikojë edhe në çmimet e agjencive turistike.

Së dyti, është një praktikë jo e konsoliduar. Domethënë, në vendet europiane nuk mbahet tatim në burim për faturat, për shërbimet që kryhen jashtë territorit të një shteti.

Ne do të sugjerim që kjo dispozitë të mos miratohet tani dhe si Dhomë Amerikane kemi bashkëpunuar me Ministrinë e Financës 2 vjetët e fundit për të asistuar për hartimin e një ligji të ri “Për tatimin mbi të ardhurat”. Ligji aktual që është i vitit ’98, është i superuar dhe ka nevojë për ndryshime, me qëllim që të akomodojë kërkesat dhe zhvillimin e biznesit. Ne do të sugjerim që kjo pikë e mbajtjes së tatimit në burim të jetë pjesë e ligjit të ri të tatimit, pra të diskutohet në kuadrin e ligjit të ri të tatimit mbi të ardhurat që qeveria, me sa jemi informuar, parashikon ta draftojë dhe ta kalojë në parlament gjatë vitit të ardhshëm.

Së fundi, Marku e përmendi, por nuk e di a ishte shumë i qartë në detaje ose jo për atë që ne i kemi propozuar Ministrisë së Financave për reformën e tatimit mbi individët, ndryshimet legislative të këtij viti sollën një ndryshim të madh në tatimin e individëve nëse ata janë punëmarrës dhe, ndryshe, nëse janë të regjistruar si persona fizikë tregtarë. Ky ndryshim e çoi qeverinë, në njëfarë mënyre, edhe në futjen e këtyre dispozitave, që i quajten dispozitë antishmangie, dhe në dispozitën që është futur në ligj, ku thuhet se një person fizik nuk mund të regjistrohet ose të ketë më shumë se disa NIPT-e.

Jemi shumë dakord dhe nuk ka asnjë kuptim për anëtarët tanë fakti që një person fizik duhet të ketë vetëm një NIPT dhe të gjitha veprimtaritë ekonomike që ushtron duhet të jenë të përmbledhura dhe të deklarohen në atë numër NIPT-i që ky person ka marrë. Por besoj se në këtë projektligj duhet të ketë një dispozitë transitore, ku të thuhet: për ata që janë aktualisht të regjistruar si të tillë, duhet të merren masa që nga 1 janari, me qëllim që edhe organi tatimor, edhe vetë personi, si të thuash, të bëjë të mundur kalimin në një NIPT të vetëm dhe mbledhjen e të gjitha detyrimeve dhe kredive që ky person mund të ketë në një NIPT të vetëm, pasi do të shkaktohen problematika në praktikë.

Së dyti, edhe fakti se personat synojnë të regjistrohen dhe të shpërndahen në më shumë se një NIPT, ose synojnë të kalojnë nga një status (i punësuar) në një status tjetër (person fizik), është pasojë e faktit që legjislacioni tatimor ka krijuar një hendek tejet të madh ndërmjet të punësuarit dhe atij që është person fizik tregtar.

Në fakt, ne i kërkuam Ministrisë së Financave që në muajin korrik se duhet menduar një reformë tatimore, me qëllim që struktura ligjore, mënyra se si ti je i regjistruar (je individ, i punësuar apo person fizik tregtar) nuk duhet të afektojë masën e tatimit për të ardhurat individuale që çdo person në njëfarë mënyre gjeneron dhe çon në shtëpi.

Do të sugjerohet që ndoshta edhe komisioni duhet ta shtyjë Ministrinë e Financave në këtë drejtim, me qëllim shmangien e këtij diskriminimi, që është bërë për efekt të tatimit mbi të ardhurat personale, bazuar në regjistrimin juridik ose në statusin e këtyre personave.

Nuk po zgjatem më shumë për detaje të tjera, sepse i kemi edhe këtu.

Në qoftë se do të keni pyetje, jam e hapur t'u përgjigjem.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit!

Kush e do fjalën në emër të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë?

Urdhëroni!

(Përfaqësuesi i Dhomës flet pa mikrofon.)

Hazbi Parllaku – Jam anëtar i kryesisë së Dhomës së Tregtisë dhe mbuloj transportin, njëkohësisht jam sekretar i Përgjithshëm për Shoqërinë e Transportit Publik Qytetas. Faktikisht, kemi bërë disa kërkesa për disa lehtësi fiskale dhe kemi pasur një korrespondencë të vazhdueshme me Ministrinë e Financave, sidomos së fundi kemi qenë edhe te zyra e Kryeministrit, e cila na ka dhënë pothuajse një përgjigje negative.

Problemi është shumë i thjeshtë, për t'i rënë shkurt. Ne kërkojmë disa lehtësi fiskale, të cilat nuk do t'i kërkonim nëse do të zbatoheshin ligjet e qeverisë, domethënë aktet nënligjore, të cilat janë për plotësimin falas të një shtrese të caktuar të shoqërisë, si shtresat në nevojë: paraplegjikët, tetraplegjikët, invalidët, të verbrit, jetimët. Arsyeja pse i kërkojmë këto lehtësi është sepse duhet t'i rimbursonte shteti. Këta udhëtojnë gratis dhe nuk i rimbursen askush. Ndaj ne kemi kërkuar disa lehtësi, si: reduktimi i TVSH-së, heqja e akcizës së qarkullimit vetëm për të rimbursuar apo për të zbutur disa nga humbjet që ne kemi, duke marrë këto shtresa pa pagesë. Besoj se ju jeni në dijeni që numri i këtyre është mjaft i lartë, duke futur këtu edhe studentët, të cilëve duhet t'i marrim 30% të biletës, si dhe duke mos konsideruar këtu abuzimin e madh që bëhet me dokumentet e invalidëve dhe me biletat e studentëve, të cilët i përdorin edhe pleqtë, por askush nuk i kontrollon.

Njëkohësisht, ka një numër shumë të madh të librezave të invalidëve, të cilat janë false, për të cilat, me gjithë denoncimet e shumta, nuk është penalizuar askush deri tani. Sakaq, mund të themi se kjo situatë e ka çuar këtë grupim apo Shoqatën e Transportit Publik Qytetas në gjendje kolapsi. Ndaj, një ngritje e lehtë e çmimit që u bë apo vetë rritja e çmimit të karburantit e ka sfumuar tërësisht, për të mos thënë e ka tejkaluar.

Për këtë çështje është ngritur edhe një grup ndërinstitutional pranë qeverisë për të parë si do të bëhet me shtresat në nevojë dhe çfarë masash do të merren për rimbursimin e këtyre shtresave nga ana e saj. Deri tani ne nuk e dimë kush bën pjesë në këtë grup dhe cilat janë rezultatet e këtij studimi, pasi u bënë tre vjet dhe nuk ka asnjë...

Na kanë kërkuar vazhdimisht studime për ndikimin e çmimit të karburantit apo çmimeve të korsive të deleguara, paguajmë studime pafund, i çojmë andej-këndeje, por përfundimisht konkluzioni është zero. Ndaj ne duam të dimë nëse do të ketë ndonjë lehtësi për të përballuar mosaplikimin e këtyre ligjeve apo nuk duhet t'i aplikojmë këto ligje, sepse njëra nga

të dyja duhet bërë, pasi ndodh një paradoks. Nëse ne kemi refuzuar dy-tri herë që t'i marrim këta invalidë, duke u thënë se qeveria duhet t'ju pajisë me biletë ose me abone, nuk është se jemi ne... Kjo situatë e vë shoqatën përballë publikut. Ky është një paradoks, sepse ne nuk jemi shoqëri bamirëse apo ndonjë institucion për të bërë politika sociale.

Kështu që, njëra nga të dyja duhet bërë, ose të na thuhet: ju nuk duhet t'i merrni ato, ama kjo duhet të thuhet publikisht, që të mos thuhet pastaj se nuk po i marrin operatorët. Për shembull, vjen kryetari i shoqatës dhe i nxit shtresat në nevojë, të cilat, në fund të fundit, kanë të drejtën e tyre, të krijojnë gjithnjë konflikte të panevojshme.

Ne duam vetëm një përgjigje si do të zgjidhet ky problem.

Së dyti, para dy-tre vjetësh Ministria e Transportit nxori një program për *e-government*, nëpërmjet së cilës dokumentet dhe certifikatat, licenca e të tjerë do të jepeshin online, pra edhe elektronikisht. Më e keqja është se aktualisht certifikatat janë bllokuar për efekt të transferimeve që kanë ministritë dhe organet e kontrollit gjobisin shoferët ose operatorët që janë pa certifikata, ndërkohë që ato nuk mund ta marrin certifikatën. Ky është një problem tejet urgjent, që ndodh edhe sot që flasim.

Këto probleme kemi.

Pra, do të donim një përgjigje të saktë, sepse përgjigjja që kemi është shumë evazive, çka nënkupton se nuk do t'i marrin parasysh. Duket pa sens. Çfarë nuk do të marrësh parasysh, ligjet e qeverisë? Këto kishim.

Erion Braçe – Faleminderit!

Kush tjetër e do fjalën?

Urdhëroni!

Bledar Mankollari – Përshëndetje!

Përfaqësoj Dhomën Gjermane. Faleminderit për dëgjesën!

Për sa i përket paketës fiskale, ne ngritëm një grup pune dhe i nisëm komentet tona te Ministria e Financave, por do t'ju dërgojmë edhe juve. Janë të detajuara kështu siç folën edhe kolegët parafolës.

Për sa i përket buxhetit për vitin 2019, dua të sjell në vëmendjen tuaj pjesën e rimbursimit të TVSH-së që planifikohet për vitin 2019. Është një problem që e kanë bizneset. Është bërë një hap pozitiv për sa i përket nxjerrjes nga skema e TVSH-së të bizneseve nënkontraktore fason, e cila do ta ulë akumulimin e TVSH-së. Por mendoj se duhet parë edhe një

formë raporti ose planifikimi sa shpejt do të kthehet rimbursimi i TVSH-së dhe ajo që është akumuluar ndër vite për bizneset.

Pozitive është që procedurat janë përsheptuar shumë, por ndoshta ky është edhe efekt anësor pse përmirësimi i procedurave të rimbursimit ka sjellë edhe një përsheptim të rikthimit të TVSH-së te bizneset. Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit edhe juve!

Kush tjetër e do fjalën? Keni diçka tjetër për të thënë ose për të shtuar? Nuk keni.

Atëherë, unë do të doja ta falënderoja secilin prej jush edhe që ishte prezent, edhe që parashtrori këtu opinionin e tij lidhur me projektligjet financiare, që shoqërojnë buxhetin e shtetit dhe vetë buxhetin e shtetit!

Natyrisht, këtu u shtruan edhe çështje, të cilat e tejkalojnë suazën e diskutimit që ne kemi të paketës fiskale dhe të buxhetit të shtetit. Ndaj do të doja t’ju informoja që parimisht edhe ne kemi rënë dakord, madje e kemi presuar fort Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave për ta rishikuar ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, për të sjellë një ligj të ri në standard qoftë për shkak të kohës kur ai është miratuar, por edhe për shkak të ndryshimeve të njëpasnjëshme që janë bërë në këtë ligj dhe që janë ndërhyrje të shumta, të cilat mund të kenë sjellë edhe kakofoni brenda tij. Kështu, ne i kemi propozuar Ministrisë së Financave që brenda tremujorit të parë të vitit të sjellë ligjin e ri “Për tatimin mbi të ardhurat”. Ndërkohë, kolegët e Komisionit të Sigurisë bëjnë me dije që edhe ligji “Për masat shtesë të sigurisë” do t’i nënshtrohet një procesi riverifikimi apo rishikimi në Kuvendin e Shqipërisë lidhur me dy kërkesat konkrete për të rishikuar ligjet, që erdhën qoftë nga zonja që përfaqëson Dhomën Italiane të Tregtisë, qoftë edhe nga zotëria që përfaqëson Dhomën Amerikane të Tregtisë.

Gjithashtu, do të doja t’ju informoja se në këtë komision janë zhvilluar debate të gjera lidhur me projektligjet e paketës fiskale, kemi në proces për të marrë parasysh edhe disa nga pretendimet që ju paraqitët këtu dhe që kohë pas kohe i janë adresuar këtij komisioni lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar, veçanërisht në aspektin e bujqësisë. Do ta shikojmë edhe këtë që propozoni këtu tani për të njëzuar shërbimin human në shërbimin përkundrejt kafshëve në Shërbimin Veterinar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do ta diskutojmë, sepse nuk e kemi pasur deri tani. Por tani që ju na e thatë, nesër mund t’ia paraqesim ministrit. Gjithashtu, për sa u përket bujqësisë dhe mjeteve elektrike që përdoren

në transportin publik, për të reduktuar edhe atje tatimin mbi vlerën e shtuar; për të reduktuar tatimin mbi vlerën e shtuar edhe për sa i përket botimit, shitjes dhe tregtimit të librave, qoftë edhe për të rregulluar atë që ju thatë, se ka një diskordancë për sa u përket formulimeve që kanë ardhur në raport me TVSH-në e fasonistëve. Këto ishin për sa i përket ligjit “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, pastaj me radhë në secilin prej ligjeve, natyrisht edhe për çështjen e zhavorreve bituminoze, që ka qenë një shqetësim i ngritur edhe pranë këtij komisioni dhe të cilin e kemi diskutuar edhe me ministrin, do të bëjmë një propozim disa përqindje më poshtë sesa propozimi që ka sjellë vetë qeveria në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Ndërkohë, kemi hapur një diskutim lidhur me propozimin e qeverisë për rentën minerare, që do të vendoset në industrinë e kromit, duke menduar se bëjmë mirë po ta vendosim rentën minerare apo atë diferencim që vendoset për të edhe në industritë e tjera përpunuese brenda vendit. Ky është një diskutim i hapur, që ne do të vazhdojmë ta zhvillojmë gjatë ditës së nesërme edhe me ministrin e Financave. Ndërkohë, e dëgjova me shumë vëmendje zotin Aleksi lidhur me taksën e infrastrukturës, por do të duhet të bëj një saktësim. Taksën e infrastrukturës e kemi 1% deri në 3%, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, ne nuk flasim vetëm për Tiranën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, më vjen keq. Taksa për infrastrukturën...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Person m – ...që kemi dorëzuar është 4-8% në të gjithë Shqipërinë.

Erion Braçe – Ju lutem! Sipas ligjit që ne kemi në fuqi, taksa për infrastrukturën është 1-3%. Për qytetin e Tiranës është 4-8%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Person m – Unë e di shumë mirë, e ka 4-8%, për të tjerat nuk jam përgjegjës...

Erion Braçe – Ta verifikojmë këtë gjë, por ka një diferencë këtu, që u jep atribut këshillave bashkiakë të vendosin për këtë gjë. Natyrisht, është në përgjegjësinë e këshillave bashkiakë të bëhen të përgjegjshëm në këtë aspekt, të bëjnë edhe politikë zhvillimore, ashtu siç duhet të bëjnë edhe politikë sociale në këtë aspekt. Prandaj u kemi dhënë gjithë këtë diskrecion këshillave bashkiakë, që të bëhen të përgjegjshëm, të mos bëhen klientelistë dhe thjesht marrës në këtë aspekt, por të bëjnë edhe një politikë zhvillimore.

Praktikisht, unë besoj se 8% është vendosur për qendrën e Tiranës, jo për zonat jashtë daljes së saj. Megjithatë, në këtë proces e kemi në diskutim, përkundrejt seancës që kemi nesër. Pa asnjë lloj diskutimi, shqetësimi që sjell zoti Arshova do t'i adresohet nesër ministrit, kur të diskutojmë pjesën e shpenzimeve buxhetore, me qëllim që të sqarojmë një herë e përgjithmonë këtë shqetësim të përsëritur sa herë ka problematika të këtij lloji.

Ju falënderoj pa masë për prezencën tuaj!

Media le të qëndrojë pak, sepse kam për t'i komunikuar diçka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për atë qëndrova edhe unë, sepse kam parë gjëra që nuk lidhen as me faktin, as me atë që praktikisht është procedurë ligjore e parashikuar. Siç e dini, tre anëtarët e bordit, që i përkasin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ndjekin këtë procedurë: vetëpropozohen, siç janë vetëpropozuar pranë institucioneve teknike të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Secili prej tyre është vetëpropozuar. Vetëpropozimi është administruar nga sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, pra jo nga Komisioni i Ekonomisë. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit ka organizuar seancën dëgjimore me secilin prej tyre, ku pavarësisht prezencës së shumtë të anëtarëve të Komisionit të Ekonomisë, kanë qenë të ftuar gjithë deputetët e Kuvendit, se kështu është procedura, që të vetëpropozuarit u prezantohen të gjithë deputetëve të Kuvendit. Ka një arsye pse bëhet kjo, sepse janë deputetë, që, nga lista e madhe e të vetëpropozuarve, duhet të propozojnë anëtarët me 28 firma, kandidatët e mundshëm, për tri vendet vakante në Bankën e Shqipërisë. Ky proces nuk ka ndodhur.

Pra, lajmet që Komisioni i Ekonomisë ka propozuar tre emra për anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, që i përkasin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, nuk janë të vërteta. Komisionin i Ekonomisë nuk ka asnjë atribut të propozojë. Propozojnë deputetët duke mbështetur me firma dhe, në dijeninë time, deri tani deputetët nuk kanë propozuar asnjë emër, as të majtë, afërmendsh, as të djathtë, sepse e djathta është në një pozicion të caktuar në raport me Kuvendin.

Në dijeninë time, deputetët e së majtës, pra të Partisë Socialiste, nuk kanë ndër mend të propozojnë në emër të PD-së. Po, është e vërtetë, unë dhe zonja Tabaku, si drejtues të këtij komisioni, jemi takuar, por në asnjë rast, as zonja Tabaku, afërmendsh, as unë, nuk kemi folur për emra, qofshin këta të së majtës apo propozime të deputetëve të majtë në Kuvendin e

Republikës së Shqipërisë, qofshin emra që vijnë nga deputetët e djathtë në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Kështu që në këtë rast përdorimi i emrave është tërësisht i pavërtetë dhe, të them të drejtën, edhe i padrejtë. Për më tepër, ato çka kam lexuar në disa portale (me detyrim, se m'i kanë dërguar) apo gazeta, sidomos këto historitë me komplote, për negociata e të tjera më radhë, janë tërësisht të rreme, të pavërteta. Nuk kam negociuar me kurrkënd, për asnjë emër. Në krahun tjetër, deri më sot nuk ka asnjë propozim, për asnjë emër.

Jam interesuar sot në mëngjes pranë sekretarisë së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe asnjë listë deputetësh nuk ka propozuar ndonjë emër për anëtar të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Në momentin kur deputetët do të propozojnë emra, atëherë është Komisioni i Ekonomisë ai që do të organizojë seancat dëgjimore me të gjithë kandidatët, qoftë me kandidatët që vijnë nga ana e qeverisë, qoftë me kandidatët që propozohen nga deputetët e Kuvendit.

Kjo është e vërteta deri tani. Kur të ketë ndonjë gjë më shumë se kaq, pa asnjë lloj diskutimi, do të jem i hapur t'ju përgjigjem. Më vjen tmerrësisht keq, sidomos me median e shkruar, që përhap lajme të rreme, kur, në fakt, unë jam vetëm një telefonatë larg. Mund t'i binit telefonit, të më pyesnit dhe unë do t'ju sqaroja, edhe procedurën, edhe komplotin në këtë rast.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka një afat: përgjegjshmërinë e gjithsecilit në raport me funksionimin normal të Bankës së Shqipërisë. Bëtë mirë që ma bëtë këtë pyetje. Kemi pasur mbledhje grupi pak më herët, edhe atje kam thënë të njëjtën gjë. Do të vazhdoj të insistoj fort që deputetët të jenë të përgjegjshëm, qofshin këta edhe të opozitës, pavarësisht pozicionit që kanë marrë përkundrejt Kuvendit, që të bëjnë propozime sa më parë të jetë e mundur. Bëhet fjalë për Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, i cili në rang nuk është këshilli mbikëqyrës i një bordi kullimi, pavarësisht se në dimër edhe bordet e kullimit marrin një rëndësi aq të madhe, sa nuk ka ku të shkojë.

Edhe një herë, duhet të jenë të përgjegjshëm të gjithë deputetët e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim që të plotësojnë detyrat që kanë në raport me Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Ata e kanë marrë këtë atribut kur është miratuar ligji "Për Bankën e Shqipërisë". Ky atribut u ka ardhur deputetëve, tani ata le të reflektojnë sa më parë përgjegjshmëri, për të vënë në lëvizje Komisionin e Ekonomisë dhe Financave dhe për të vijuar më tutje me procedurën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk gjykoj asnjë. Unë gjykoj kur më vijnë përpara në komision. Kështu muhabetesh për njërin-tjetrin unë nuk bëj dot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jua thashë edhe pak më herët. Gjithsecili që vjen në Komisionin e Ekonomisë dhe në Kuvend, është kandidat. Në qoftë se jeni mësuar me faktin që ai që propozohet bëhet, atëherë e keni gabim. Në këtë komision ka ndodhur të jenë rrëzuar edhe mbi 20 kandidatura në grup, njëri pas tjetrit, individualisht, për institucione të rëndësishme. Ju e dini shumë mirë.

Unë nuk kam vlerësim për asnjë individ. Vlerësimin e bën Komisioni i Ekonomisë dhe Financave dhe më pas deputetët me votë në seancë plenare. Mos më kërkoni të shprehem për njerëz që do të më duhet t'i dëgjoj në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave për vizionin e tyre, natyrisht, edhe për përgjegjshmërinë e tyre në ushtrimin e detyrës për të cilën kanë kandiduar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë jam vetëm kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe deputet. Grupet parlamentare i drejtojnë njerëz të tjerë. Kështu që drejtuesit e grupeve parlamentare duhet të bëjnë detyrën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër. Nuk ka kuorum Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë dhe ky është shqetësimi im prioritar. Përtej emrave, shqetësimi im më i madh është funksionimi normal i Këshillit Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, i cili duhet të marrë çdo muaj vendime.

Faleminderit edhe juve!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti